A.K.P.A.
Nr 3108 Prot.
Datë,më 24.11.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME TEKNOLOGJIKE "HYSEN ÇELA"DURRËS

Nr 83 Prot. Durrës, më 18.11 2026

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Rruga ''Bulevardi Bajram Curri', Tiranë

Në zbatim të ligjit nr.15/2019, "Për nxitjen e punësimit", të ligjit nr.15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhëzim Nr.759, datë 30.9.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar".

Shkolla e mesme teknologjike "Hysen Çela" ju njofton krijimin e vendit të lire për pozicionin:

- Pozicioni: 1 Mësues i teorisë/praktikës profesionale, drejtimi Hoteleri-Turizëm.

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

1. **Kritere të përgjithshme:** a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën; c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale; d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar; e) të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit; f) të demostrojë aftësi drejtuese, të punës në grup dhe motivimit.

2. Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

2.Kritere të posacme për mësues të teorise profesionale:

a) Të ketë diplomë të nivelit master professional ose të barasvlefshme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit publik të AFP-së; b) të ketë të paktën 1(një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit; d) aftësi të tjera nësë kërkohen.

3. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë: a) letërmotivimin për pozicionin; b) jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit në shtojcën 11 të këtij udhëzimi ; c) kartën e identitetit; d) diplomen; e)librezën e punës; f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV ; g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit; h) vërtetimi të gjendjes shëndetësore; i) vërtetim të gjendjes gjyqësore; j)vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi; k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara .

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit në Shkollën e Mesme Teknologjike "Hysen Çela", brenda afatit 03 . 12 .2026

3.Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr.759, datë 27.5.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë,menaxhimin e burimeve njerëzore,përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve,ofruesve të arsimit dhe formimit professional dhe zhvillimit të vazhduar professional të personelit", i ndryshuar.

DREJTORE

Dr. Blerina DERVISHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SHKOLLA E MESME TEKNOLOGJIKE "HYSEN ÇELA" DURRËS